

VENDIM
Nr. 250, datë 29.9.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ES 2019” SHPK, “PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 480, SERIA T21, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 23, DATË 25.1.2021”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 5 germa “dh”; nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, germa “d”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017, nenit 18, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.9.2022 mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1625/4 prot., datë 27.9.2022 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ES 2019’ sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 23, datë 25.1.2021, ka licencuar shoqërinë “ES 2019” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar.

- Shoqëria “ES 2019” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 1617 prot., datë 21.9.2022, ka bërë me dije se për shkak të ndryshimit të strukturës së tregut të energjisë elektrike, elementeve të krizës/rritjes së skajshme të çmimeve në tregjet rajonale të energjisë elektrike e ka pasur të pamundur të realizojë aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe si e tillë kërkon heqjen e licencës nr. 480, seria T21, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 23, datë 25.1.2021.

- Shoqëria ka dokumentuar edhe kryerjen e pagesës së rregullimit për vitin 2022 në vlerën respektive dhe rezulton se kjo shumë ka kaluar në llogarinë e ERE-s dhe shoqëria nuk është debitoare ndaj pagesave të rregullimit.

- Kërkesa e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike mbështetet në parashikimet e nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në të cilin citohet se: ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit; si dhe nenit 5, germa “dh”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, e cila parashikon, se: “Licenca hiqet me kërkesë të të licencuarit”.

- “Rregullorja për procedurat e heqjes së licencës në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, neni 7, paragrafi 2, përcakton se: “Në rast se nga i licencuarit është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje”.

- Rregullorja për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në nenin 9, germa “d” të saj, përcakton se: “...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2, të kësaj rregulloreje”.

- Në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, legjislacioni në fuqi i sipërcituar, i jep ERE-s të drejtën ligjore për t’u shprehur me një vendim miratimi pa kaluar më parë në fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 480, seria T21, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 23, datë 25.1.2021.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca e sipërcituar humbet fuqinë juridike.

3. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti